



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË GJYKATËS SË LARTË

Tiranë, më 01.04.2021

Me datë 01.04.2021, ora 10.00, me kërkesën dhe nën drejtimin e Zv/Kryetarit të Gjykatës së Lartë, z. Sokol Sadushi, u zhvillua mbledhja e Këshillit të Gjykatës së Lartë.

Mbledhja e Këshillit të Gjykatës së Lartë, e cila i ishte njoftuar 3 ditë para anëtarëve të Këshillit së bashku me materialet përkatëse, kishte në rend dite çështjet si vijon:

1. Intervistimi dhe vlerësimi i kandidatëve të kualifikuar për fazën e dytë të procedurës së pranimit në Shërbimin Civil Gjyqësor në Gjykatën e Lartë,
2. Përshtatja e organikës së Gjykatës së Lartë, sipas vendimit nr.84, datë 11.03.2021 “Për detajimin e numrit të punonjësve për vitin 2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”,
3. Caktimin e 4 (katër) gjyqtarëve të emëruar së fundmi nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në Kolegjet përkatëse,
4. Të ndryshme.

Këshilli i Gjykatës përbëhej nga anëtarët si vijon:

1. Sokol SADUSHI - Zv/Kryetar i Gjykatës së Lartë
1. Ilir PANDA - Anëtar Gjykatës së Lartë
2. Kelment GRECA - Përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor

Të pranishëm në mbledhjen e Këshillit të Gjykatës ishin edhe:

- 1) znj. A.V., me detyrë Drejtore e Kabinetit të Kryetarit të Gjykatës së Lartë
- 2) z. M. K., me detyrë Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit
- 3) znj. B.A., me detyrë sekretare gjyqësore, e ngarkuar për të mbajtur dhe zbardhur procesverbalin audio të mbledhjes.
- 4) znj. V.XH., me detyrë specialiste IT

Në fjalën hyrëse, Zv/Kryetari i Gjykatës së Lartë, z. Sokol Sadushi, pasi konstatoi prezencën e dy anëtarëve të tjerë të Këshillit, deklaroi të hapur mbledhjen e Këshillit, me rendin përkatës të ditës, i cili u miratua, vijoi me çështjen e parë të rendit të ditës, që lidhej me intervistën dhe vlerësimin e kandidatëve për plotësimin e disa pozicioneve të shpallura vakant në Gjykatën e Lartë, dhe konkretisht:

1. Pozicionin Drejtor, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore Financiare dhe Shërbimeve.
2. Pozicionin Drejtor, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë.
3. Pozicionin Specialist, në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore Financiare dhe Shërbimeve, dhe:
4. Pozicionin Specialist, në Sektorin e Publikimeve dhe Statistikave, Qendra e Dokumentacionit.

Këshilli i Gjykatës, pasi zhvilloi intervistën me të 4 (katër) kandidatët, i vlerësoi ata me një performancë të mirë, dhe bëri një pikëzim në shifra për secilin prej tyre si vijon:

- Për kandidatin për pozicionin e Drejtorit të Burimeve Njerëzore Financiare dhe Shërbimeve – 28 pikë
- Për kandidatin për pozicionin e Drejtorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë – 33 pikë
- Për kandidatin për pozicionin e Specialistit në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore Financiare dhe Shërbimeve – 26 pikë
- Për kandidatin për pozicionin e Specialistit në Sektorin e Publikimeve dhe Statistikave, Qendra e Dokumentacionit – 28 pikë

Duke patur parasysh edhe faktin që këta kandidatë e kanë kaluar fazën e parë me një nivel pikësh të kënaqshëm, që të gjithë janë mbi 50 pikë së bashku me këto pikët e marra nga intervista, e kalojnë nivelin 70% që është kufiri minimal për tu kualifikuar në fazën tjetër. Në këto kushte Këshilli konkludoi se kandidatët që kanë konkuruar në pozicionet përkatëse do të konsiderohen si të miratuar në këto pozicione.

Pika tjetër e rendit të ditës lidhej me përshtatjen e organikës së Gjykatës së Lartë sipas vendimit nr. 84, datë 11.03.2021 *“Për detajimin e numrit të punonjësve për vitin 2021”* të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në bazë të të cilit organikës së Gjykatës së Lartë i shtoheshin për vitin 2021 edhe 6 (gjashtë) nëpunës gjyqësorë të rinj.

Këshilli u njoh me analizën e nevojave të Gjykatës të përgatitur nga kabineti i Kryetarit të Gjykatës së Lartë, se në cilët sektorë janë më të nevojshëm shpërndarja e këtij numri prej 6 (gjashtë) nëpunësish. Mbi bazën e kësaj analize, sugjerohej se sektorët që kishin nevojë prioritare për shtim të organikës, bazuar kjo në faktorë të tillë si ngarkesa e punës, ekzistenca e numrit aktual të nëpunësve në këta sektorë, janë Drejtoria e Administrimit Gjyqësor dhe Qendra e Dokumentacionit, për të cilat sugjerohej që në Drejtorinë e Administrimit Gjyqësor 2 (dy) nëpunës të caktoheshin tek Sektori i Rregjistrimit dhe 1 (një) tek Sekretaria Gjyqësore, ndërsa në Qendrën e Dokumentacionit, 2 (dy) nëpunës të caktoheshin tek Sektori i Publikimit dhe Statistikave dhe 1 (një) tek Sektori i Kërkimit Ligjor dhe Biblotekës.

Këshilli i Gjykatës u shpreh dakort me gjetjet dhe sugjerimet e paraqitura dhe vendosi që të shpërndarjë 6 (gjashtë) nëpunësve shtesës si vijon në përputhje me këto sugjerime.

Pika tjetër e rendit të ditës kishte të bënte me caktimin e 4 (katër) gjyqtarëve të rinj të sapo ardhur në Gjykatën e Lartë në Kolegjin Civil, Penal dhe Administrativ. Kryetari i Këshillit i bëri me dije anëtarëve të tjerë të Këshillit që në momentin që sapo kanë ardhur gjyqtarët e rinj, është zhvilluar Mbledhja e Përgjithëshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, për të diskutuar lidhur me ndarjen e gjyqtarëve në Kolegje. Nisur nga fakti të të 4 gjyqtarët e rinj kanë ardhur nga fusha penale, për rrjedhojë, sipas ligjit, ata konsiderohen automatikisht si gjyqtarë në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë. Megjithatë, në funksion të mbarëvajtjes së punës së Gjykatës së Lartë, u është kërkuar gjyqtarëve të Kolegjit Penal, për të qenë pjesë e trupave gjyqësore të Kolegjeve të tjera, për aq sa është e mundur, të cilët kanë shprehur dakortësinë për këtë.

Sipas propozimit të paraqitur për ndarjen e trupave gjykuese të Kolegjeve, tashmë përveç 3 (tre) Kolegjeve që krijohen automatikisht, do të krijohen brenda çdo Kolegji 2 (dy) trupa gjykuese, trupa të cilët lidhen me ndërthurjen e gjyqtarëve mes Kolegjeve të ndryshme. Qënia e 2 (dy) trupave brenda çdo Kolegji, dhe përcaktimi i kalendarit të punës për secilin prej tyre, përbën një efektivitet akoma më të madh për Gjykatën e Lartë, sepse jep mundësinë që të punohet në mënyrë intensive dhe të këtë rendiment e gjithë puna e bërë, për më tepër që ardhja e gjyqtarëve të rinj e justifikon, ose më mirë të themi kënaq atë pritshmëri që ka në opinionin publik, për evadimin sa me shpejt të çështjeve të tyre.

Për çdo Kolegji, propozimet për 2 (dy) trupat gjykues që krijohen, janë konkretisht:

Kolegji Penal

Trupi gjykues nr.1

1. z. Ilir Panda
2. zj. Albana Boksi
3. z. Klodian Kurushi

Trupi gjykues nr.2

1. z. Ilir Panda
2. z. Sokol Binaj
3. z. Sandër Simoni

Kolegji Civil

Trupi gjykues nr.1

1. z. Ervin Pupe
2. zj. Albana Boksi
3. z. Sandër Simoni

Trupi gjykues nr.2

1. z. Ervin Pupe
2. z. Sokol Sadushi
3. z. Ilir Panda

Kolegji Administrativ

Trupi gjykues nr.1

1. z. Sokol Sadushi
2. z. Sokol Binaj
3. z. Klodian Kurushi

Trupi gjykues nr.2

1. z. Sokol Sadushi
2. z. Ilir Panda
3. z. Ervin Pupe

Këshilli i Gjykatës miratoi ndarjen e gjyqtarëve në Kolegje dhe trupat gjykues përkatës.